

Statistikat e Transportit

Prill, 2017

Tiranë, më 29 Maj 2017: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Prill 2017 është 394 mijë/ton. Krahasuar me Prill 2016, ky tregues është rritur me 2,6 %.

Në katër mujorin e parë 2017, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.231 mijë/ton, duke u rritur me 6,3 %, krahasuar me të njejtën periudhë të vitit 2016.

Porti i Durrësit zë 90,4 %, të gjithë mallrave të ngarkuara/shkarkuara në të gjitha portet.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 3,5 milionë ton për kilometër dhe është rritur 93,7 %, krahasuar me Prill 2016.

Në katër mujorin e parë 2017, volumi i mallrave për kilometër është 6,8 milionë ton, duke u rritur 102,8 % në krahasim me të njejtën periudhë të vitit 2016.

Tab. 1 Volumi i ngarkim-shkarkimit të mallrave në porte, Prill 2017

000/ton

Periudha	Gjithsej	Durrës	Porte të Tjerë
Prill 2016	384	348	36
Prill 2017	394	356	38
Ndryshimi vjetor (%)	2,6	2,3	5,6
Janar- Prill 2016	1.158	1.057	101
Janar - Prill 2017	1.231	1.143	88
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	6,3	8,1	-12,9

Tab. 2 Transporti i mallrave me hekurudhë, Prill 2017

Periudha	Volumi i mallrave 000/ ton.km	Volumi i mallrave 000/ ton
Prill 2016	1.817	21
Prill2017	3.519	28
Ndryshimi vjetor (%)	93,7	31,1
Janar - Prill 2016	3.369	30
Janar- Prill 2017	6.832	46
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	102,8	52,2

Në muajin Prill 2017, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 139 ton duke u rritur 4,5 %, në krahasim me Prill 2016.

Në katër mujorin e parë të 2017 volumi i mallrave të transportuara është 543 ton, duke u rritur 3,6 %, krahasuar me një tën periudhë të një viti më parë.

Tab. 3 Transporti i mallrave dhe postës me ajër, Prill 2017

Periudha	Mallra ton	Posta ton
Prill 2016	133	39
Prill2017	139	35
Ndryshimi vjetor (%)	4,5	-10,3
Janar - Prill 2016	524	169
Janar - Prill 2017	543	146
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	3,6	-13,6

Në transportin ajror janë kryer 1.770 fluturime, duke shënuar një rritje me 6,4 %, ndaj Prill 2016.

Në katër mujorin e parë 2017, janë kryer 6.874, duke u ritur me 6,5 %, krahasuar me një tën periudhë të një viti më parë.

Tab. 4 Treguesit e transportit ajror, Prill 2017

Periudha	Nunri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri mbikalimeve
Prill 2016	15	1.664	10.778
Prill 2017	15	1.770	11.959
Ndryshimi vjetor (%)	-	6,4	11,0
Janar- Prill 2016	15	6.454	35.888
Janar- Prill 2017	15	6.874	36.207
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-	6,5	0,9

Në muajin Prill, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 189.763, duke u rritur 27,9 %, krahasuar Prill 2016.

Në katër mujorin e parë 2017, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 697.804, duke u rritur me 22,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Transporti ajror i pasagjerëve gjatë kësaj periudhe zë peshën më të madhe me 71,5 % të totalit.

Tab.5 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Prill 2016	9.930	56.828	148.330
Prill 2017	4.933	100.340	189.763
Ndryshimi vjetor (%)	-50,3	76,6	27,9
Jan.- Prill 2016	34.550	228.828	571.951
Jan.- Prill 2017	7.918	269.916	697.804
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-77,1	18,0	22,0

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 100.340 persona, krahasuar me Prill 2016, ky tregues është rritur 76,6 %.

Gjatë katër muajve të parë të vitit 2017, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 269.916, duke u rritur me 18,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 6 Transporti i mallrave 2007-2016

000/ton

Vitet	Transporti hekurudhor i mallrave	Transporti detar i mallrave	Transporti ajror i mallrave dhe Posta
2007	399	4.332	4
2008	355	4.705	3
2009	343	4.193	2
2010	403	4.170	2
2011	317	4.067	3
2012	142	3.984	2
2013	151	4.001	2
2014	338	4.067	2
2015	198	3.840	2
2016	76	3.756	2

Tab. 7 Transporti i pasagjerëve, 2007-2016

000/pasagjerë

Vitet	Transporti hekurudhori	Transporti detar	Transporti ajror
2007	1.091	925	1.107
2008	822	1.080	1.260
2009	645	1.160	1.395
2010	430	1.120	1.537
2011	453	1.166	1.817
2012	448	1.101	1.665
2013	329	1.009	1.757
2014	187	1.095	1.810
2015	189	1.186	1.977
2016	69	1.289	2.139

Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.